



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 15868/2 Prot

Tiranë, më 5/10/2023

**URDHËR**

Nr. 2321, Datë 5.10.2023

**“PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE  
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR  
“ADOPTIMI PËR HERË TË PARË I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË  
RAPORTIMIT FINANCIAR (SNRF 1)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar “Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 1)”.
2. Ndryshimet e SNRF 1 “Adoptimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”, të publikuara në Gusht 2023, njësia ekonomike i zbaton në të njëjtën kohë kur zbaton ndryshimet e SNK 21.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

**MINISTËR**

**Ervin METE**

